



Financuar nga
Bashkimi Evropian


center for
transparency
and freedom of
information

ema
EUROPEAN MOVEMENT ALBANIA

Raport

2025

RAPORT MONITORIMI, GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, 2024



PUBLIKUES

QENDRA PËR TRANSPARENÇË DHE INFORMIM
TË LIRË (CTFI)

Adresa: Rr. Komuna e Parisit, Pal.2, Sh. 2,
Tirana, Albania

Tel: +355 682088602

E-mail: info@transparence.al

Web: www.transparence.al

VITI I PUBLIKIMIT:

2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE” , me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Hyrje	03
Organigrama	03
Buxheti	04
Kosto për çështje	11
Stoku	12
Transparenca	14
Gjetjet dhe përfundimet	15
Rekomandimet	17
Bibliografia	18

Hyrje

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë funksionon që nga data 1 shkurt 2023 si e vetmja gjykatë Apeli nga 6 të tilla që ishin deri para kësaj date kur u mor vendimi [1] i KLGJ për Hartën e re gjyqësore.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, shqyrton në shkallë të dytë, çështjet që lidhen me ankimet ndaj vendimeve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Berat, Gjirokastrë, Dibër, Sarandë dhe Kukës. Vendimet e gjykatës së apelit janë të formës së prerë.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm shqyrton gjithashtu si juridiksion fillestar, çështjet për të cilat ligji parashikon një procedurë të tillë gjykimi, siç janë gjykimet për kërkesat për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja apo arbitrazhit, si dhe ankimet ndaj vendimeve të Agjencisë së Trajtimin të Pronave.

Organigrama

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka një staf sipas vendimit prej 245 punonjësish punonjësish duke përfshirë trupën gjyqësore 78 gjyqtarë dhe stafin administrativ 167 punonjës. Numri faktik është më i vogël 152 pozicione të plotësuara, 26 gjyqtarë nga 78, me ndihmës ligjorë 22 nga 32, me sekretarë gjyqësorë 55 nga 82 dhe staf tjetër administrativ mbështetës 49 nga 53 [2].

Gjatë vitit 2024 kanë ushtruar mesatarisht efektivisht detyrën 26 gjyqtarë në krahasim me vitin 2023 ku ushtronin detyrën mesatarisht 23 gjyqtarë ose ndryshe 33% e numrit të gjyqtarëve sipas dekretit. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka në përbërje veç drejtorit, 2 specialistë buxheti, 2 specialistë finance.

Apeli menaxhon edhe zyrat e shërbimeve që ushtrojnë veprimtarinë në godinat e ish-gjykatave të apeleve në rrethe të cilat përbëhen nga tre nëpunës civilë gjyqësorë.

Gjatë vitit 2024, janë shpallur vendet vakante për sekretarë gjyqësorë në total 25, nga të cilat janë plotësuar 6 me lëvizje paralele dhe 12 me procedurë pranim në shërbimin civil gjyqësor.

[1] Vendimi i KLGJ-së nr. 505, datë 21.11.2022

[2] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 f.15-16

Me vendimin nr.495, datë 21.10.2020, të KLGJ-së është vendosur krijimi i Njësive të Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apeleve. Struktura e Njesisë së Shërbimit Ligjor është e përbërë nga një numër prej 32 pozicionesh ndihmësish ligjorë. Për vitin 2024, ushtrojnë detyrën efektivisht 22 ndihmës ligjorë. Numri aktual i ndihmësve ligjorë efektivë në gjykatë plotëson vetëm 69% të strukturës fillestare të miratuar nga KLGJ dhe vetëm 28% të nevojës sipas ligjit [3]. Gjyqtarët e Apelit paguhën sipas grupit G2 të pagave. Ndërkaq 8 gjyqtarë të pezulluar nga vetingu paguhën me 75% të pagës deri në përfundim të vendimit të KPA.

Buxheti

Buxheti i miratuar për këtë gjykatë në fillim të vitit buxhetor 2024 është në shumën 521.300.000 lekë [4], ose afërsisht 5.2 milionë euro. Në fund të vitit 2024 me shtesat dhe pakësimet e miratuara gjatë vitit 2024 buxheti ishte në shumën 509.239,200 lekë, ose afërsisht 5 milionë euro. Realizimi për vitin 2024 është në shumën 495.748.071 lekë ose në masën 97.35% e buxhetit të rishikuar. Buxheti i miratuar për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, është më i lartë në vlerë 10.968 mijë lekë ose në masën 2.15%.

Artikulli 600, shpenzime paga, është pakësuar në shumën 55,000 mijë lekë[5].

Artikulli 601, shpenzime sigurime, është shtuar në shumën 3,000 mijë lekë. Artikulli 602, shpenzime për mallra dhe shërbime, është shtuar në shumën 48.510 mijë lekë.

Artikulli 606, shpenzime për transf. buxh. familjare & ind., është shtuar në shumën 499.2 mijë lekë [6].

[3] Shënim: KLGJ ka propozuar një alternativë ligjore që mund ta zgjidhë këtë problem dhe të çojë në rritjen e numrit të personelit mbështetës në gjykata. Ndryshimet ligjore të propozuara synojnë rritjen e numrit të ndihmësve ligjorë deri në dy ndihmës ligjorë për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, rritjen e trajtimit të tyre financiar si një mjet nxitës për përzgjedhjen e kësaj karriere nga ana e profesionistëve të së drejtës dhe lehtësimin e procedurave të rekrutimit të tyre duke parashikuar të njëjtën procedurë me rekrutimin e nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë në gjykata.

[4] Vendimi i KLGJ nr. 743, datë 28.12.2023, "Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për Sistemin Gjyqësor"

[5] Vendimi i KLGJ nr. 761, datë 27.12.2024, "Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024"

[6] VKM nr. 846, datë 26.12.2024 "Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore"

Artikulli 231, shpenzime kapitale (investime), është pakësuar në shumën 3.070.000 lekë nga Ministria e Financës si dhe vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në nivel artikulli realizimi i buxhetit të Apelit për 2024 është si më poshtë:

Artikulli 600 (paga) me fond në shumën 402.800.000 lekë, ndërsa realizimi për vitin 2024, është në shumën 344.763.412 lekë ose në masën 99% e buxhetit vjetor. Përveç pagave mujore të vitit 2024, me këtë fond janë likuiduar edhe të gjitha diferencat e lindura nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pagat e magjistratëve, paga neto dhe të gjitha detyrimet e lindura për sigurimet shoqërore, shëndetësore, sigurimin suplementar dhe tatimin mbi të ardhurat për të gjitha gjykatat e apeleve të cilat e mbyllën aktivitetin e tyre më 31.01.2023 [7].

Megjithatë shpenzimet për paga në vitin 2024 ishin më të vogla se ato në vitin 2023 në masën 7%. Shpenzime personeli në vitin 2023 ishin 420.118 në mijë lekë ndërsa në vitin 2024 ishin 389.800 në mijë lekë.

Edhe artikulli 601, sigurimet shoqërore u realizua në masën 99% e buxhetit të planifikuar.

Artikulli 602, mallra dhe shërbime të tjera, fondi ishte në shumën 78.510.000 lekë mijë lekësh dhe realizimi është afërsisht në masën 100%. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit me materiale e shërbime zyre, kancelari, shtypshkrime, shpenzime për udhëtim e dieta, etj. Janë kryer likuidimet e shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, posta, energji elektrike, shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, dhe shpenzime të tjera speciale, si pagesa ekspert psikolog e avokat, tatim taksa si dhe ekzekutim vendime gjyqësore.

Kostot e Apelit për shërbime dhe nevoja të tjera janë të listuara në tabelën më poshtë [8]:

Artikulli	Shpenzimi në fakt	Pesha në %
602 Mallra dhe shërb. tjera	78,378,768	100.00%
6020 Materiale e shërbime zyre	9,674,267	12.34%
6020100.2 Letër dhe Kancelari	2,712,492	3.46%

[7] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 f.89-96

[8] Po aty, f.94

6020200.1 Materiale Pastrimi	416,940	0.53%
6020200.4 Karburant për kalda.jë	801,826	1.02%
6020400 Tonera (shërbim printimi)	3,192,509	4.07%
6020500 Shtypshkrime	852,500	1.09%
6020900 Materiale të vogla rutine	342,000	0.44%
6021001 Veshje uniforma	1,356,000	1.73%
6022 Shërbime	13,003,112	16.59%
6022001 Energji Elektrike	4,864,964	6.21%
6022002 Ujë	600,431	0.77%
6022003.3 Telefoni celularë	12,500	0.02%
6022004 Posta dhe Shërbimi Korrier	7,525,217	9.60%
6023 Shpenzime transporti	2,197,826	2.80%

6023100.1 Karburant për automjet	1,070,386	1.37%
Siguracione	225,000	0.29%
6023900.2 Shpenzime larje makine	88,000	0.11%
6025600 Mirëmbajtje Mjeteve të Transportit	814,440	1.04%
6024 Shpenzime udhëtimi	1,269,544	1.62%
6024100.1 Dieta administrative	753,390	0.96%
6024200 Dieta administrative jashtë shtetit	516,154	0.66%
6025 Shpenz. mirëmbajtje të zakonshme	509,560	0.65%
6021002 Mirëmbajtje lulishte	118,800	0.15%
6025300 Mirëmbajtje godine	68,000	0.09%
6025400 Mirëmbajtje pajisje kondicioneri	152,760	0.19%

6025400.1 Mirëmbajtje pajisje kalda je	170,000	0.22%
6029 Shpenzime të tjera operative	51,724,459	65.99%
6027400 Ekzekutime Vendimi	43,227,922	55.15%
6029002 Shpenz. për Aktivitete Sociale	30,000	0.04%
6029005.1 Shpenz. Pagesë eksperti	888,800	1.13%
6029005.2 Shpenz. Pagesë psikologu	647,010	0.83%
6029005.3 Shpenz. Pagesë Avokati	5,774,000	7.37%
6029005.5 Shpenz. Përkthime	609,097	0.78%
6029005.6 Pagesë komisioni për tenderat	232,646	0.30%

Nga tabela shihet se shpenzimi më i lartë është ai i etiketuar ‘shpenzime të tjera operative’ dhe ‘ekzekutime vendimi’ ndërsa shpenzimet më të ulëta janë ato për aktivitete sociale, telefon celular dhe larjen e makinave. Shpenzimet për postën janë 9% dhe për avokatin kryesisht 7%. Në total për grupin buxhetor, shpenzime korente, realizimi është në masën 99.26%.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm kishin një fond në shumën 40.430.000 lekë, ndërsa realizimi gjatë vitin 2024 është në shumën 30.361.461 lekë ose 75.10 %. Tenderat e zhvilluar më fondin e mësipërm janë ato që lidhen me “Rikonstruksionin e godinës, ambienteve, rrjetit elektrik, rrjetit kompjuterik, rrjetit të detektimit të zjarrit”.

Arsyet e mosrealizimit lidhen me një tender i cili ka dështuar si rezultat i produktit jashtë standardit ai për “Blerje rafte metalike arkivore të lëvizshëm dhe statikë për nevojat e institucionit” fituar me vlerën 9.989.280 lekë me TVSH. Pas përfundimit të furnizimit dhe vendosjes së rafteve në ambientet e arkivit të gjykatës, u konstatua që këto rafte nuk ishin sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe nuk u morën në dorëzim nga komisionet përkatës dhe fatura për to nuk u likuidua.

Ndërtesa, dy thirrje për qera nga KLGJ dhe Apeli.

Apeli i Juridiksionit të Përgjithshëm thekson që në fillim të analizës vjetore se KLGJ duhej ta kishte prioritet sigurimin e një ambienti ku Gjykata e Apelit të ushtrojë veprimtarinë saj me dinjitet [9].

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vazhdon ta ushtrojë aktivitetin në të njëjtën godinë që ka pasur Gjykata e Apelit Tiranë, një godinë prej tre katesh e përshtatur për gjykatë (jo e projektuar si e tillë prej themeleve), në të cilën janë të akomoduar të gjithë gjyqtarët dhe stafi administrativ dhe vendosur 7 sallat e gjyqit dhe salla e pritjes së qytetarëve. Kjo godinë nuk përmbush kushtet parësore që një gjykatë e këtij niveli duhet të përmbushë.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave [10] marrë në mars të vitit 2025 është miratuar kalimi i godinës së ndodhur në zonën kadastrale 8150, me numër pasurie 6/277, Tiranë për t’u përdorur për ushtrimin e aktiviteteve administrative për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Bëhet fjalë për ish ndërtesën drejtorisë së Tatimeve për bizneset VIP.

Ishte ky vendim i qeverisë që ndërpreu një përpjekje të KLGJ për të zgjidhur në një mënyrë tjetër çështjen e ambienteve të Apelit, pas mungesës së përgjigjes nga qeveria dhe pushteti lokal në lidhje me leje ndërtimi apo ambient.

KLGJ në fund të vitit 2024 (12.12.2024) dhe në fillim të vitit 2025 (06.01.2024) janë bërë dy thirrje nga KLGJ të ribotuara edhe në faqen e Gjykatës së Apelit për zyra me qera të cilat duhej të ishin me sipërfaqe jo më e vogël se 7.000 m² dhe jo më e madhe se 8.860 m².

Në thirrje specifikoheshin edhe ambientet si ne vijim: Objekti duhet të ofrojë akomodim për një staf total prej rreth 320 punonjësish, nga të cilët 78 do të jenë gjyqtarë, të cilët nevojitet të kenë ambiente pune (zyra) me sipërfaqe rreth 12 m². Sa i takon pjesës tjetër të administratës mbështetëse (ndihmësa ligjorë, sekretarë gjyqësorë, staf administrativ etj., objekti duhet të ofrojë akomodim në ambiente pune të tipit zyra për 2, 3 apo 4 punonjës ose ambient pune të tipit ‘open space office’, duke konsideruar në çdo rast ofrimin e një sipërfaqeje pune prej mesatarisht 6 – 8 m² për çdo individ.

[9] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 f.5

[10] VKM Nr.173, Datë 20.03.2025, për “Ndryshimin e Përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të pronës me emërtimin “Dega e Tatimpaguesve të Mëdhenj”, ndodhur në Zonën Kadastrale 8150, me numër pasurie 6/227, Tiranë.

Objekti duhet të ofrojë ambiente për zhvillimin e seancave gjyqësore, (salla gjyqi penale dhe civile), sipërfaqja dhe numri i të cilave janë të specifikuara në fillim të këtij dokumenti. Pra, 14 (katërmëdhjetë) salla penale me sipërfaqe $\pm 60 \text{ m}^2$, 12 (dymbëdhjetë) salla civile me sipërfaqe $\pm 40 \text{ m}^2$ si dhe ambientet e tjera të specifikuara si sallë mbledhesh ($\pm 100 \text{ m}^2$); ambiente për arkiva (2 nga 100 m^2 ose një ambient $\pm 200 \text{ m}^2$).

Objekti duhet të ofrojë një ambient, mundësisht në hyrje të ndërtesës, me sipërfaqe rreth 100 m^2 , nga ku do të jepen shërbimet e kryesekretarisë.

Objekti duhet të ketë minimalisht 3 hyrje, njëra prej të cilave të jetë në anën e pasme pasi do të shërbejë për hyrjen e të pandehurve, njëra për stafin e gjykatës dhe e treta për publikun.

Kusht për kualifikim ishte çmimi më i ulët në lekë për 1 m^2 .

Pasi nuk ka pasur oferta KLGJ ka shpallur sërish edhe njëherë kërkesën për ambient me qera në 6 janar të vitit 2025 me të njëjtat kërkesa. Nisur nga çmimet e qerasë në Tiranë (mesatarisht 5-10 euro/ m^2) dhe periferinë e saj, pagesa e qerasë për një ndërtesa me kërkesat e mësipërme shkon afërsisht sa 10% e buxhetit vjetor të Apelit.

Pavarësisht se qeveria ka ofruar shtesë ambienti për Apelin, vetëm 100 metra larg nga ndërtesa aktuale, sërish çështja do të mbetet pa zgjidhur për njëfarë kohe që lidhet me rikonstruksionin e ndërtesës së re. Dhënia e një ndërtesë shtesë për Apelin nuk e zgjidh përfundimisht problemin e hapësirave të nevojshme për funksionimin normal të saj. Ky problem zgjidhet vetëm me ndërtimin e ri të ndërtesës së Apelit sipas nevojave dhe standardeve [11].

Në raportin vjetor të Apelit theksohet nevoja për investim në disa sektorë si ai i digjitalizimit të disa proceseve administrative duke pilotuar edhe krijimin e dosjes elektronike.

Po aty theksohet nevoja e krijimit të arkivit aktiv me qëllim lirim të ambienteve të zyrave nga dosjet gjyqësore në pritje për gjykim. Mungesa e një arkivi qendror [12] për çështjet aktive, sjell edhe një vështirësi më shumë duke kërkuar një kohë dhe ndërmarrje të madhe nga i gjithë stafi i gjykatës për të identifikuar rishortimet, vendndodhjen fizike të dosjes gjyqësore apo edhe rishpërndarjen e organizimit të zyrave të gjyqtarëve dhe stafit që vështirësohet nga pamjaftueshmëria e tyre. Bie në sy ngarkesa e madhe e arkivit të Apelit. Gjatë vitit 2024 arkivi ka marrë afro 2800 kërkesa për dokumente.

Një investim tjetër i nevojshëm për Apelin është instalimi i një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme. Ashtu edhe një alokim fondesh për investim për plotësimin e nevojave për rikonstruksion të dhomës të serverit [13].

[11] Takim në KLGJ me drejtorin e buxhetit, Xhevdet Haxhiu, 04 korrik 2025

[12] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 f.10

[13] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.96,97

Pavarësisht se raporti thekson zgjerimin e Apelit, në fund të tij theksohet se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk mund të plotësojë më nevojat për hapësira pune dhe gjykimi dhe se është bërë emergjente që KLGJ në bashkërendimin me ekzekutivin të marrë të gjitha masat për krijimin e një infrastrukturë tjetër të re tërësisht të ngritur nga e para me sipërfaqet e nevojshme për salla gjykimi dhe ambiente pune dhe administrative [14].

Kosto për çështje

Nga programi 3301 'Buxheti gjyqësor' në raportin e monitorimit të buxhetit për vitin 2023 në aneksin 3 është llogaritur edhe kosto për një çështje gjyqësore ose ndryshe për produktin A, 'çështje të gjykuara', mbështetur mbi buxhetin e shpenzuar në grupin shpenzime korente.

Për vitin 2024 numri i çështjeve të shqyrtuara ishte gjithsej 9850, ndërsa buxheti i shpenzuar për këto çështje, pra vetëm shpenzimet korente (pagat, sigurimet, shpenzime të tjera) ishte 465,386,610 lekë. Kosto për një çështje është 47247 [15] lekë. Kosto është më e ulët se në vitin 2023 për shkak se numri i çështjeve të shqyrtuara është më i madh përgjatë vitit 2024.

Për vitin 2023 në total numri i çështjeve të shqyrtuara ishte 8812, shpenzimet korente faktike 459,944.840 lekë, ndërsa kosto për një çështje ishte 52.195 lekë

Ndërsa për vitin 2023 (tremujori i parë) sasi faktike e çështjeve ishte 2337, shpenzimet faktike 84,697.69 dhe kosto për njësi 36.242 lekë. Të paktën një muaj në këtë periudhë është punuar sipas hartës së vjetër gjyqësore.

Për vitin 2022: Sasia faktike e çështjeve të shqyrtuara ishte 3305; shpenzimet e vitit 2022:164,166, 700 lekë; nga del edhe kosto për njësi për këtë vit: 49,672 lekë.

Pra ka një rritje të vogël të kostos për njësi në vitin 2023 dhe më pas sërish rënie të saj në raport me vitin 2022 kur nuk ishte zbatuar ende harta e re gjyqësore.

Kosto për një çështje është më e madhe në Apel se sa në gjykata të tjera për shkak se një çështje zgjat në kohë ndërkohë që shoqërohet me shpenzime që nuk janë në shumë gjykata të tjera si avokatët, ekspertët, psikologët, përkthime, etj.

[15] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.99

Varianca e kostos për çështje në vitet 2022-2024

Viti	Numri i çështjeve	Shpenzimet korente	Kosto për çështje/lekë
2022 (Apeli, Tiranë)	3305	164,166,700	49,672
2023	8812	459,944.840	52.195
2024	9850	465,386,610	47247

Stoku

Me një trupë gjyqësore prej 26 gjyqtarësh, Apeli ka zhvilluar 9850 çështje gjyqësore ndërsa qëndron ende larg qëllimit kryesor që pati harta e re gjyqësore e zbatuar përgjatë vitit 2023 [16], thuhet që në hyrje të analizës vjetore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Apeli kritikon KLGJ si organi qendror përgjegjës i cili duhej të kishte zhvilluar me shpejtësi proceset e promovimit të gjyqtarëve dhe rritur progresisht numrin e tyre në gjykatë si dhe shtimin e ndihmësve ligjorë.

Në fund të vitit 2024 stoku i çështjeve arriti në 41700 çështje nga 37662 çështje që ishte në fillim të vitit 2024, me një rritje prej 10.7% ose 4,038 çështje më shumë se një vit më parë

Dominimi i çështjeve civile vihet re në 67.4% të backlog-ut, ndërsa 32.6% janë çështje penale, duke treguar sfidën më të madhe në trajtimin e çështjeve civile.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u regjistruan gjatë vitit 2024 13,888 çështje të reja, një rënie prej 4.3% krahasuar me vitin e kaluar. Në çështjet e reja të regjistruara në vitin 2024 përfshihen edhe 334 çështje të ardhura nga Gjykata e Lartë për rigjykim po pranë kësaj gjykate [17].

Ngarkesa mesatare për gjyqtar, WR është rritur në 1,945.3 çështje për gjyqtar në vitin 2024 nga 1,903.6 çështje në vitin 2023.

Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) paraqitet në vlerën 371.1 çështje për gjyqtar, ndërsa në vitin 2023 ishte 340.9.

[16] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.2

[17] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.17

Normës e likuidimit të çështjeve CR është 64.2% për çështje civile dhe 76% [18] për çështjet penale duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2023. Apeli ka arritur të evadojë afro 70.9 % të ngarkesës me vetëm afro 30% të trupës gjyqësore në shërbim.

Treguesi DT për vitin 2024 është 1545 ditë dhe krahasuar me të dhënat e vitit 2023 prej përkatësisht 1673 ditë pëson një rënie të lehtë prej 8% [19].

KLP të shpjegojë më tej rreth shpenzimeve në pjesën shpjeguese të raportit vjetor të monitorimit të buxhetit. Kjo pasi ndihmon në kuptimin e këtyre shpenzimeve edhe për persona që kanë njohuri të zbehta rreth formularëve të raportimit.

KLP të trajtojë në raportet e saj vjetore çështjen e stokut në prokurori. Në vitin 2022 kjo çështje është prekur lehtë ndërsa në vitin 2023 kjo çështje nuk është prekur. Në vitin 2024 është vendosur zhvillimi i një studimi në lidhje me stokun në dy prokurori dhe më pas do të ndërtohet një strategji. Është fakt se stoku në çështje penale në gjykata është më i vogël se sa në çështje civile dhe administrative por megjithatë ka stok në çështjet penale. Adresimi i stokut nga prokuroria është i avashtë dhe ndërkaq edhe i paqartë në hapat që ndërmerren në raport me ato që po kryen tashmë gjyqësori dhe i pakoordinuar me këtë të fundit.

Përmirësimi i treguesit DT (koha mesatare e gjykimit), rezulton se për çështjet civile ka rënë nga 2790.7 ditë në 2683 ditë (-4%); ndërsa për çështjet penale ka rënë nga 885.2 ditë në 823 ditë (-7%) [20].

Çështjet e regjistruara rreth 3-5 vite më parë nga viti i raportimit zënë numrin më të madh të çështjeve në pritje të gjykimit prej 16602 (40%). Vendin e dytë, me 6803 (16%), e zënë çështjet e kategorisë 1-2 vjet. Ndërsa 5608 (14%) çështje presin prej 2-3 vitesh për t'u shqyrtuar nga gjykata e apelit. Me moshën më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 4254 të cilat përbëjnë 10% të backlog-ut të vitit 2024 [21].

Gjykata e Apelit projektton të rrisë normën e likuidimit të çështjeve CR në 100 % për vitin 2025 dhe tejkalimi i këtij standardi në vitet në vijim me qëllim uljen e stokut [22], Apeli parashikon të përfundojë stokun në 5-6 vjet nëse do të jetë e mundur të plotësohet numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në 78 gjyqtarë.

[18] Ka mosrakordim shifrash mes raportit vjetor të KLGJ dhe Raportit të Apelit për vitin 2024. Ndryshe nga sa më sipër që është shifër e publikuar nga KLGJ, raporti vjetor i Apelit të Përgjithshëm thekson se për vitin 2024 në GJAJP rezulton në nivelin 71%, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2023 ku CR ishte 68% por ende larg standardit ndërkombëtar.

[19] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.34

[20] Raporti vjetor i KLGJ, 2024, f.94

[21] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.37

[22] Po aty f.96

Rritja e stokut dhe varianca e DT në Apel 2021-2024

Viti	Stoku/nr.çështjesh	DT/numër ditësh
2021	28140	893,9
2022	31370	5995,3 (Ap.Tiranë)
2023	37662	1673
2024	41700	1545

Për të ndihmuar procesin e uljes së stokut, Kuvendi duhet të miratojë nismat ligjvënëse të depozituara nga KLGJ prej kohësh të cilat do të mundësonin dyfishimin në organikë të ndihmësve ligjorë, nëpërmjet një procedure tjetër, jo të formuar nga Shkolla e Magjistraturës, por nëpërmjet konkurrimit në meritë si nëpunësit e tjerë civile gjyqësore, për të cilët parashikohet edhe një trajtim i veçantë financiar. Po ashtu reduktimin stokut do të ndihmonte edhe miratimi nga Kuvendi i nismave të natyrës procedurale për shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile dhe në Ligjin nr. 49/2012 që lidhen me rrethin e çështjeve për të cilat nuk lejohet ankim dhe rekurs, si edhe për mënyrën e gjykimit në apel të disa kategorive të caktuara të çështjeve me trupë gjykuese monokratike.

Apeli vlerëson mbështetjen me 6 NUNCP, të angazhuar me mbështetjen e Projektit të Asistencës të SHBA “Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Përmirësimi i Efikasitetit”, për të cilin theksohet në raportin vjetor se ka rezultuar efektiv. Apeli kërkon që nëse krijohen kushtet të mundësohet vijimi i këtij bashkëpunimi pas ndërprerjes së tij në fund të vitit 2024 [23].

Transparenca

Në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve janë 24 kërkesa për informacion përgjatë vitit 2024. Nga këto 3 kërkesa kanë marrë përgjigjen në tejkallim të afateve të parashikuara në ligj, periudhën kohore prej 10 ditësh.

Ndërsa 21 kërkesa kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore. Në të gjitha rastet nuk është publikuar përgjigja por vetëm është lajmëruar fakti se është kthyer përgjigje.

Tek programi i Transparencës të dhënat e buxhetit janë paraqitur për vitin 2024, 2023, 2022, 2021. Është përfshirë raporti i monitorimit të buxhetit. Po ashtu janë publikuar edhe regjistrat e prokurimit për vitin 2024 si dhe për vitet 2022 dhe 2023.

Regjistri i prokurimit është publikuar me kryqëzim gjuhësh shqip dhe anglisht në një format ta paakorduar me gjykatat e tjera.

Pranë zyrës së protokollit janë protokolluar edhe shumë shkresa/kërkesa me shkrim ose në format elektronik. Gjatë vitit 2024 ka pasur një numër shumë të lartë kërkesash për informacion dhe nga ana e Zëvendëskryetares dhe Kancelares janë trajtuar rreth 3.000 shkresa.

Gjatë vitit 2024, në drejtim të rritjes së transparencës dhe aksesit në drejtësi, ka vijuar ofrimi i shërbimit nëpërmjet pajisjes “ Infopoint” të vendosur në hollin e gjykatës ku publiku, avokatët, përfaqësuesit ose palët kanë mundësi të marrin informacion në kohë reale nga faqja zyrtare e internetit të gjykatës ose sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve në gjykatë në çdo kohë pa pasur nevojë të pyesin apo të presin në radhë te zyra e informacionit.

Gjetje dhe përfundime

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka një staf sipas vendimit prej 245 punonjësish punonjësish duke përfshirë trupën gjyqësore 78 gjyqtarë dhe stafin administrativ 167 punonjës. Numri faktik është më i vogël 152 pozicione të plotësuara, 26 gjyqtarë nga 78, me 22 ndihmës ligjorë nga 32, me 55 sekretarë gjyqësorë nga 82 dhe staf tjetër administrativ mbështetës 49 nga 53.

Buxheti për 2024 ishte në shumën 521.300.000 lekë [24], ose afërsisht 5.2 milionë euro. Në fund të vitit 2024 me shtesat dhe pakësimet e miratuara gjatë vitit 2024 buxheti ishte në shumën 509.239,200 lekë, ose afërsisht 5 milionë euro. Realizimi për vitin 2024 është masën 97.35% e buxhetit të rishikuar.

Buxheti i miratuar për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, është më i lartë në masën 2.15%. Janë pakësuar shpenzimet për paga dhe shpenzimet kapitale por janë shtuar të tjera. Shpenzimet për postën janë 9% dhe për avokatin kryesisht 7%. Në total për grupin buxhetor shpenzime korrente realizimi është në masën 99.26%.

Shpenzime kapitale realizimi është 75.10 %. Arsyet e mosrealizimit lidhen me një tender i cili ka dështuar si rezultat i produktit jashtë standardit.

[24] Vendimi i KLGJ nr. 743, datë 28.12.2023, "Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për Sistemin Gjyqësor"

Për vitin 2024 kosto për një çështje është 47247[25] lekë. Ka një rritje të vogël të kostos për njësi në vitin 2023 dhe më pas më 2024 sërish rënie të saj në raport me vitin 2022 kur nuk ishte zbatuar ende harta e re gjyqësore.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vazhdon ta ushtrojë aktivitetin në të njëjtën godinë që ka pasur Gjykata e Apelit Tiranë, një godinë prej tre katesh e përshtatur për gjykatë (jo e projektuar si e tillë prej themeleve). Me vendimin e Këshillit të Ministrave marrë në mars të vitit 2025 është miratuar kalimi i një ndërtese tjetër në pronësi të KLGJ për gjykatën e Apelit.

Në fund të vitit 2024 (12.12.2024) dhe në fillim të vitit 2025 (06.01.2024) janë bërë nga KLGJ dy thirrje të ribotuara edhe në faqen e Gjykatës së Apelit për zyra me qera të cilat duhej të ishin me sipërfaqe jo më e vogël se 7.000 m² dhe jo më e madhe se 8.860 m².

Nevojitet buxhet që lidhet me rikonstruksionin e ndërtesës së re. Në raportin vjetor të Apelit theksohet nevoja për investim në disa sektorë si ai i digjitalizimit të disa proceseve administrative duke pilotuar edhe krijimin e dosjes elektronike.

Nevoja e krijimit të arkivit aktiv me qëllim lirim të ambienteve të zyrave nga dosjet gjyqësore në pritje për gjykim dhe shpejtësinë e menaxhimit. Gjatë vitit 2024 arkivi ka marrë afro 2800 kërkesa për dokumente.

I nevojshëm instalimi i një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme.

Pavarësisht se raporti thekson zgjerimin e Apelit, në fund të tij theksohet se është emergjente që KLGJ në bashkërendimin me ekzekutivin të marrë të gjitha masat për krijimin e një infrastrukturë tjetër të re tërësisht të ngritur nga e para me sipërfaqet e nevojshme për salla gjykimi dhe ambiente pune dhe administrative [26].

Pajisjet kompjuterike me të cilat punojnë gjyqtarët dhe stafi janë prodhim i vitit 2011 deri në vitin 2024. Në gjykatë punohet kryesisht me programin word 2016 – 2019.

Në dhjetor të vitit 2024 ka përfunduar rikonstruksioni i rrjetit të ri elektrik dhe kompjuterik.

Me një trupë gjyqësore prej 26 gjyqtarësh, Apeli ka zhvilluar 9850 çështje gjyqësore.

Në fund të vitit 2024 stoku i çështjeve arrit në 41700 çështje nga 37662 çështje që ishte në fillim të vitit 2024.

Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) paraqitet në vlerën 371.1 çështje për gjyqtar, ndërsa në vitin 2023 ishte 340.9.

[25] Raporti i monitorimit të buxhetit, 2024, GJAJP, aneksi 3.2

[26] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.99

Normës e likuidimit të çështjeve CR është 64.2% për çështje civile dhe 76% [27] për çështjet penale duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2023. Apeli ka arritur të evadojë afro 70.9 % të ngarkesës me vetëm afro 30% të trupës gjyqësore në shërbim.

Treguesi DT për vitin 2024 është 1545 ditë dhe krahasuar me të dhënat e vitit 2023 prej përkatësisht 1673 ditë pëson një rënie të lehtë prej 8% [28]. Me moshën më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 4254 të cilat përbëjnë 10% të backlog-ut të vitit 2024 [29].

Gjykata e Apelit projekton të rrisë normën e likuidimit të çështjeve CR në 100 % për vitin 2025 dhe tejkalimi i këtij standardi në vitet në vijim me qëllim uljen e stokut [30];

Apeli parashikon të përfundojë stokun në 5-6 nëse do të jetë e mundur të plotësohet numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në 78 gjyqtarë.

Ka mosrakordim shifrash mes raportit vjetor të KLGJ dhe Raportit të Apelit për vitin 2024 në lidhje me vlerën e CR (norma e likuidimit të çështjeve).

Në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve janë 24 kërkesa për informacion përgjatë vitit 2024. Nga këto 3 kërkesa kanë marrë përgjigjen në tejkalim të afateve të parashikuara në ligj, periudhën kohore prej 10 ditësh. Ndërsa 21 kërkesa kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore. Në të gjitha rastet nuk është publikuar përgjigja por vetëm është lajmëruar fakti se është kthyer përgjigje.

Rekomandime

Kuvendi duhet të miratojë nismat ligjvënëse të depozituara nga KLGJ prej kohësh të cilat do të mundësonin dyfishimin në organikë të ndihmësve ligjorë, nëpërmjet një procedure tjetër, jo të formuar nga Shkolla e Magjistraturës, por nëpërmjet konkurrimit në meritë si nëpunësit e tjerë civile gjyqësore, për të cilët parashikohet edhe një trajtim i veçantë financiar.

[25] Raporti i monitorimit të buxhetit, 2024, GJAJP, aneksi 3.2

[26] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.99

[27] Ka mosrakordim shifrash mes raportit vjetor të KLGJ dhe Raportit të Apelit për vitin 2024. Ndryshe nga sa më sipër që është shifër e publikuar nga KLGJ, raporti vjetor i Apelit të Përgjithshëm thekson se për vitin 2024 në GJAJP rezulton në nivelin 71%, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2023 ku NLÇ ishte 68% por ende larg standardit ndërkombëtar.

[28] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.34

[29] Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, 2024 (Raporti vjetor) f.37

[30] Po aty f.96

Po ashtu reduktimin stokut do të ndihmonte edhe miratimi nga Kuvendi i nismave të natyrës procedurale për shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile dhe në Ligjin nr. 49/2012 që lidhen me rrethin e çështjeve për të cilat nuk lejohet ankim dhe rekurs, si edhe për mënyrën e gjykimit në apel të disa kategorive të caktuara të çështjeve me trupë gjykuese monokratike.

Gjykata duhet të avancojë shpejt me sigurimin e financimeve për rikonstruksionin e ndërtesës së re në dispozicion të Apelit.

Bibliografia

Legjislacioni dhe Akte Ligjore

- Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitin 2023”, i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
- Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar
- Vendimi i KLGJ-së nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë
- Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë
- Vendimi i KLGJ nr.553, datë 29.12.2022 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm”
- Vendimi i KLGJ nr. 743, datë 28.12.2023, “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për Sistemin Gjyqësor”
- Vendimi i KLGJ nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”
- VKM Nr.173, Datë 20.03.2025, për “Ndryshimin e Përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të pronës me emërtimin “Dega e Tatimpaguesve të Mëdhenj”, ndodhur në Zonën Kadastrale 8150, me numër pasurie 6/227, Tiranë

Analizë dokumentesh për institucionin e monitoruar

- Analiza vjetore e gjykatës së Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për vitin 2024
- Pasqyra e numrit të punonjësve, sipas strukturës organizative dhe organikës në fakt, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2024
- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023
- Regjistri i parashikimeve të prokurimeve, 2024
- Regjistri i realizimeve të prokurimeve 2024
- Raporti vjetor i KLGJ 2024
- Raporti vjetor i KLGJ 2023

Burime të tjera

- Anjeza Bani, Drejtore e Buxhetit, Komunikim